

## MARTESA

**T**ë vluarit në Mirditë bëhet që në djep. Me këtë mënyrë djali edhe çupa nuk kanë rast që të njihen më parë se të vijë bashkimi i tyre. Në të zgjedhurit e të vluarës meren parasysh a është shtëpia e nderçme, çfarë lloj njerëzish janë prindërit, edhe a është i mirë daja i çupës. **Një** shtëpi ka dëshirë të madhe të bëjë krushqim me një tjaër të nderçme e të fortë, sepse me këtë mënyrë edhe pozita e saj i forcohet. Atëherë munt të thomi se objekti kryesor i martesës ka qënë, siç është edhe me familjet mbretimore të botës dhe me familjet e mëdha, forcimi mytyel i familjeve.

Përgjithësisht, mosha e burrit është m' e madhe se e gruas, kurse shumë herë qëllon që një e ve munt të marë një burrë më të ri se të veten e saj. Kjo nofia vjen nga që shtëpia e djalit munt të mos ketë gra edhe ka nevojë për një femrë me eksperiencë. Grat' e veja çmohen më tepër prandaj edhe pagesa e tyre është m' e madhe. Për shëmbëlli, për një grua të ve e të remunt të jatin 25 - 30 qese (50 - 60 napolona), kurse vajzat e kanë 10 - 15 qese (20 - 30 napolona). Shkaku është se ato janë të rahura me vajzat e me uthull edhe gjatë në ç' do vatht.